



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjilan
Gilan Belediyesi

PROPOZIM

Në bazë të nenit 11, paragrafi 1, 2, nënparagrafi 2.1, 2.2 dhe 2.3, paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit nr.04/L-144 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i dt.22 Nëntor 2012; nenit 38, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 i Statutit të Komunës së Gjilanit, për qëllimin e rregullimit të infrastruktures rrugore të “Lagja e Zabelit “ , rruga “Vehbi Ibrahim”, pas Rekomandimit të Komitetit për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë, 01.Nr.115/2015 i dt.08.10.2015 dhe Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me date 30.10.2015, miraton këtë :

V E N D I M

Për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private për nevoja të rrugës publike “ Vehbi Ibrahim” në Lagjen “Zabeli i Sahit Agës” Gjilan.

1. Kuvendi i Komunës së Gjilanit **Aprovon propozimin e Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës komunale me pronën private për nevoja të rrugës publike “Vehbi Ibrahim” në Lagjen Zabeli i Sahit Agës” në Gjilan.**
2. **Lejohet këmbimi i pjesës prej 127 m² të ngastrës kadastrale: P-70403013-01133-12, lloji i njësisë-parcelë, lloji i pronës - private, zona-urbane, me sipërfaqe prej 1482 m², te vendi i quajtur “Zabeli i Sahit Agës” Zona Kadastrale Gjilan, lloji i shfrytëzimit të parcelës– tokë bujqësore, shfrytëzimi aktual i parcelës- arë e klasit 3, e pronarit Qamil (Jakup) Selimi, me vendbanim në Gjilan, rr. “ Vehbi Ibrahim” p.n.**

Sipërfaqja prej 127m² e pronës private e cekur më lartë të këmbëhet me pjesën e pronës komunale nga ngastra kadastrale :P-70403013-01296-0, lloji i pronës : pronë shoqërore, zona: urbane, vendi i quajtur “ Zabeli i Sahit Agës”, Zona Kadastrale Gjilan, me sipërfaqe prej 228895 m², lloji i shfrytëzimit të parcelës – kullosë e klasit 4, e evidentuar në emër të P.Sh. Kuvendi i Komunës Gjilan.

3. **Obligohet Kryetari i Komunës, që pas plotëfuqishmërisë së këtij Vendimi të bëjë kërkesë Ministrisë për Financa-ZVPP për vlerësimin e pronave të paluajtshme të cilat janë objekt i këmbimit dhe të lidhin Kontratë për këmbimin me pronarin privat të cekur në nenin II të këtij vendimi duke u bazuar në raportet e vlerësimit nga Ministria përkatëse.**
4. **Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të bënë parcelimin e ngastrës komunale dhe asaj private, sipas raportit të vlerësimit dhe pas lidhjes së kontrates mes Kryetarit të Komunës dhe pronarit privat të bënë regjistrimin e pronave të këmbëra në Regjistrat Kadastral.**

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizem dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë e KK-Gjilan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.
6. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

01.Nr. 016-105970
Gjilan, më 30.10.2015

Kryesuesja e Kuvendit

/Valentina Bunjaku-Rexhepi/